

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"PJESE KEMBIMI C.G.C" SHPK**

Sot me daten 15/10/2024 (dymijë e njëzet e katër ), unë ortaku themelues :

- **I Z. Amarildo Dedolli**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 13 Mars 1995, lindur në Klos dhe banues në Klos, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. ID J50313078R

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar* " PJESE KEMBIMI C.G.C" SHPK.

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të quhet " PJESE KEMBIMI C.G.C" SHPK.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Fushë Kruje, Larushk, Zone Kadastrale Nr.2385, Nr pasurie 140/45, Vol 7, Fq12

**NENI 3**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Pjesë kembimi te përdorura, Autoservis, Shitje Blerje automjeteve, Import-Export të automjeteve dhe pjesëve të kembimit të përdorura.

**NENI 4**  
**KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë " PJESE KEMBIMI C.G.C" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 1 kuota, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kontributi i ortakeve është i ndare si vijon:

**1. Amarildo Dedolli zotëron 1 kuota baraz me 100 % të kapitalit.**

**NENI 5**  
**KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**



Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

#### **NENI 6**

#### **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administrator i shoqërisë do të jetë Z. Amarildo Dedolli, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

#### **NENI 7**

#### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqëritë Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **NENI 8**

#### **NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumatat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

#### **Neni 9**

#### **LIKUIDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj, operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjisllacionin tregtar shqipëtar.

#### **NENI 10**

#### **MOSMARRËVESHJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Fushe Kruje për zgjidhje.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË  
" PJESE KEMBIMI C.G.C" SH.P.K**



**AMARILDO DEDOLLI**

Amarildo Dedolli

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'A. Dedolli', with a stylized flourish at the end.